

V E N D I M
Nr.632, datë 23.9.1996

PËR AKTIVIZIMIN E MJEKËVE PENSIONISTË NË SISTEMIN E SHËNDETËSISË

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ambientit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Mjekët pensionistë nën moshën 65 vjeç mund të aktivizohen në klinikat e QSUT deri 10 orë pune në javë.
 2. Fondi i pagave përballohet nga buxheti i QSUT.
 3. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e këtyre mjekëve përcaktohen nga ministri i Shëndetësisë dhe Ambientit.
 4. Ministria e Shëndetësisë dhe Ambientit nxjerr udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi